

Kompetencat e MZHETTS, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve, nga pikëpamja e shërbimeve bankare dhe financiare, dhe nevojat për bashkëpunim në kuadër të krijimit të strukturave dhe proceduarave të ngjashme me ato të Bashkimit Evropian

BAZA LIGJORE

Në zbatim të MSA-së, si dhe nën ndikimin e zhvillimit ekonomik dhe tregtar në Shqipëri, u adoptua një rregullim i ri ligjor për mbrojtjen e konsumatorit, nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i amenduar në korrik 2011 me qëllim harmonizimin e mëtejshëm të tij me legjislacionin përkatës të BE-së.

Ligji nr. 9902, datë 17. 04.2011 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, përcakton fushën e zbatimit të tij, ku përfshihen të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, që kanë të bëjnë me mallrat e konsumatorëve dhe shërbimet.

Në rastet, kur ka ligje specifike apo dispozita të tjera ligjore për fushat specifike, zbatohen ato dispozita që japin trajtime më të favorshme për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Kjo dispozitë ka për qëllim forcimin e mbrojtjes së pozitës së konsumatorit në treg.

Kredia konsumatore në ligjin 9902/2008, i ndryshuar,
rregullohet nëpërmjet neneve 44 - 45

Kredia konsumatore në këtë ligj rregullohet nëpërmjet neneve 44-45. Dispozitat ligjore synojnë të detyrojnë institucionet financiare në dhënien e informacionit të nevojshëm që konsumatorit i duhet për të bërë zgjedhjen e duhur dhe më të mirë për të.

Çdo publicitet në lidhje me marrëveshjet e kredisë, e cila tregon një normë interesi apo ndonjë shifër në lidhje me çmimin e kredisë për konsumatorët, duhet të përfshijë informacionin standard të përcaktuar në këtë nen si më poshtë:

Kredia konsumatore në ligjin 9902/2008, i ndryshuar,

rregullohet nëpërmjet neneve 44 - 45

Ky informacion standard, duhet të jepet në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme, me anë të një shembulli përfaqësues, ku të specifikohen:

Norma e huasë, fikse ose të ndryshueshme, ose të dyja së bashku, me veçoritë e çdo pagese/detyrimi të përfshira në koston totale të kredisë për konsumatorin;

- Shuma totale e kredisë;
- Norma vjetore epërqindjes së pagesave/detyrimeve apo norma efektive e interesit (NEI), siç përcaktohet me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë,
- Nëse është e zbatueshme, kohëzgjatja e marrëveshjes së kredisë;
- Në rastin e një kredie në formën e një pagese të shtyrë, për një mall ose shërbim të veçantë, çmimi në para (kesh) dhe shuma e çdo pagese në avancë;
- Shumën totale të pagesës për konsumatorin dhe shumat e pagesave për këstet.

Monitorimi

Realizimi i një vlerësimi të situatës në 16 bankat e nivelit të dytë, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin e mbrojtjes e konsumatorëve nga bankat. Sipas fazës së publicitetit dhe fazës parakontraktore:

FAZA E PUBLICITETIT

1. Përdorim i konceptit ligjor të termit “kredi konsumatore”
2. Dhënia e informacionit standard mbi elementë të tillë si:
 - Norma e huasë
 - Norma Efektive e Interesit
 - Shuma totale e pagesës për konsumatorin
 - Shumat e pagesave për këstet
3. Egzistenca e një shembulli përfaqësues

Monitorimi

Realizimi i një vlerësimi të situatës në 16 bankat e nivelit të dytë, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin e mbrojtjes e konsumatorëve nga bankat. Sipas fazës së publicitetit dhe fazës parakontraktore:

FAZA PARAKONTRAKTORE

1. Përdorimi i termit kredi konsumatore
2. Dhënia me shkrim të informacionit parakontraktor
3. Përmbajtja e informacionit parakontraktor, sipas:
 - Përshkrimi i karakteristikave të produktit të kredisë
 - Kostot e kredisë
 - Aspekte të tjera ligjore

GJETJET E VLERËSIMIT NGA MONITORIMI 2014

Mangësitë-Faza e Publicitetit	Mangësitë faza parakontraktore
<p>1. Mangësi në dhënien e informacionit lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none">a) Normën e huasë (70% nuk japin informacion)b) Normën efektive të interesit (81% nuk e japin këtë informacion)c) Shumën totale të pagesës (100% nuk e japin këtë informacion)d) Shumat e pagesave për këstet <p>2. Mungesa e shembullit përfaqësues (90% nuk e japin këtë informacion)</p>	<p>1. Mosdhënia e informacionit parakontraktor me shkrim.</p> <p>2. Mangësi në dhënien e informacionit për:</p> <ul style="list-style-type: none">- llogaritjen e NEI-t,- periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit,- kushtet penale dhe kamatëvonesat;- afati mbi të drejtën për të hequr dorë nga kontrata,- kohën e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor. <p>3. Mungesa e analizës mbi vlerësimin e përshtatshmërisë së kredisë me gjendjen financiare të konsumatorit.</p> <p>4. Përdorimi i gabuar i termit Kredi Konsumatore</p>

VENDIMI I KOMISIONIT TË MBROJTJES SË KONSUMATORË VE

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, mori **Vendimin nr. 31, datë 29.07.2014**, nëpërmjet të cilit kërkohet:

1. Bankat e nivelit të dytë të zbatojnë kushtet sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, kur kredia konsiderohet një kredi konsumatore;
2. Bankat e nivelit të dytë të marrin masat për mospërdorimin e termit “kredi konsumatore”, në rastet kur nuk plotësohen kushtet sipas dispozitave të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve” nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar,
3. Të merren të gjitha masat për përmirësimin e situatës në lidhje me dhënien e informacionit në fazën e publicitetit dhe fazën parakontraktore, përpara ofrimit të një kredie konsumatore.
4. Bankat të njoftojnë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për zbatimin e këtij vendimi, brenda 2 muajve nga marrja e njoftimit të këtij vendimi.

GJETJET E VLERESIMIT PAS DERGIMIT TE VENDIMIT TE KMK-se 2015

Përmirosimet në zbatimin e legjislacionit

Faza e Publicitetit	Faza parakontraktore
<p data-bbox="104 389 556 472">1. Dhënia e informacionit lidhur me:</p> <p data-bbox="104 544 459 626">Vendosja e fletës së standardizuar:</p> <ul data-bbox="104 698 633 983" style="list-style-type: none">a) Normën e huasëb) Normën efektive të interesit,c) Shumën totale të pagesësd) Shumat e pagesave për këstet	<p data-bbox="674 389 1450 425">1. Informacioni parakontraktor me shkrim.</p> <ul data-bbox="768 439 1709 522" style="list-style-type: none">- Informacioni i standardizuar parakontraktor i kredisë konsumatore <p data-bbox="674 594 1039 629">2. Informacioni për:</p> <ul data-bbox="768 644 1709 986" style="list-style-type: none">- llogaritjen e NEI-t,- periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit,- kushtet penale dhe kamatëvonesat;- afati mbi të drejtën për të hequr dorë nga kontrata,- kohën e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor. <p data-bbox="674 1051 1644 1086">4. Përmbushja e termit ligjor për Kredinë Konsumatore</p>

Shërbimet financiare në largësi

VKM nr. 615, datë 7.09.2011 “Për tregtimin në largësi të shërbimeve financiare për konsumatorët”

Përcakton detyrimet e tregtarit që ofron shërbime financiare ndaj konsumatorëve në largësi. Në këto shërbime financiare, përfshihet çdo lloj shërbimi me natyrë bankare, kredie, sigurimi, pensionet vullnetare, investimi, etj., i siguar konsumatorëve nëpërmjet mjeteve të komunikimit në largësi.

Tregtarët duhet t’i sigurojnë konsumatorëve informacionin e nevojshëm përpara lidhjes dhe pas lidhjes së kontratës të shërbimit financiar në largësi, që duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe jo çorientues për konsumatorin, njoftimin për të drejtën e konsumatorit për heqjen dorë nga kontrata, si dhe detyrimin për dhënien me shkrim të këtij informacioni njëkohësisht dhe të kushteve të kontratës në gjuhën shqip.

REKOMANDIME

Në këtë kuadër, do të vijojë bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, për sa i takon transpozimit të parimeve kryesore të Direktivave të fundit të BE-së, të cilat lidhen me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve, respektivisht:

1. 2014/17/EU “Për kredinë hipotekare”, që ka të bëjë me marrëveshjet e kredisë për konsumatorët me pronën e paluajtshme dhe që ka për qëllim krijimin e një tregu të kredisë hipotekare me një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit.
2. 2014/92/EU “Për krahasimin e tarifave në lidhje me llogaritë e pagesave, ndryshimin e llogarive të pagesave”. Kjo direktivë synon përmirësimin e ndjeshëm të transparencës së tarifave të llogarive bankare dhe e bën më të lehtë kalimin e një llogarie bankare nga një bankë në tjetrën.
3. Vazhdim i vlerësimit nga KMK dhe BSH për shqyrtimin e praktikave të bankave, rast pas rasti, për zbatimin e legjislacionit për Kredinë Konsumatore.

REKOMANDIME

4. Rritjen e gamës së shërbimeve financiare në largësi, në bazë të VKM nr. 615, datë 7.09.2011, për lehtësimin e konsumatorëve.
5. MZHETTS ka planifikuar gjatë periudhës 2016-2017, amendimin e Ligjit të Mbrojtjes së konsumatorëve, me synim përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe harmonizimin më të mirë me legjislacionin evropian, konkretisht direktivën e BE-së “Mbi të drejtat e konsumatorëve”.